

LIGJ
Nr.8386, datë 30.7.1998

PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E SHITJE SË PASURIVE TË PERSONAVE
JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Fusha e veprimit të ligjit

1.1 Ky ligj u jep të drejtën administratorëve të kryejnë veprimet e shitjes së pasurive të personave fizikë a juridikë, subjekte të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa ndryshime në ligjin nr.8215, 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", si dhe pasurive të ish-presidentëve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjeve të tyre, deklaruar si persona të lidhur me ta.

1.2 Përcakton mënyrën dhe procedurat që do të zbatohen nga administratorët në kryerjen e veprimeve juridiko-civile, tregtare dhe administrative për shitjen e pasurive të shoqërive, me qëllim realizimin e vlerave financiare që do të përdoren për shpërndarje kreditorëve të tyre.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

a) "Pasuri e shoqërisë" nënkupton pasurinë e shoqërive huamarrëse dhe të personave të lidhur me to, në referim të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", në të cilin futet pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme, si dhe mjetet monetare në llogarinë bankare, arkë dhe në formë cash, si dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqëri të tjera tregtare.

b) "Administrator" nënkupton shoqërinë e specializuar apo persona të caktuar sipas ligjit për administrimin, kontrollin dhe verifikimin e pasurive të shoqërive huamarrëse dhe të personave të lidhur me to, si dhe për shitjen e pasurive dhe likuidimin e tyre.

c) "Konsulentë juridikë" nënkupton juristët e caktuar pranë administratorëve për dhënien e ndihmës juridike për kryerjen e veprimeve të ndryshme juridiko-civile, procedurale civile, tregtare dhe administrative me organet administrative, gjyqësore dhe me te tretë.

d) "Grupi i vlerësimit" nënkupton ekspertët financiarë dhe ata të specialitetit teknik, vendas apo të huaj, të caktuar nga administratorët për vlerësimin e pasurisë së shoqërisë dhe caktimin e çmimit fillestar të shitjes.

Neni 3

Shitja e pasurisë

3.1 Objektet që përbëjnë pasurinë e shoqërive huamarrëse, si dhe të personave të lidhur me ta, shiten për të realizuar kthimin e tyre në vlera financiare.

3.2 Me kryejen e veprimit juridik të shitjes, e drejta e pronësisë, të drejtat reale, si dhe çdo e drejtë tjetër mbi pasurinë e shoqërisë apo të personit të lidhur me të, i kalon blerësit. Këto të drejta mbrohen me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

3.3 Ish-presidentët e shoqërive huamarrëse, pjestarët e tjerë të familjes së tyre, si dhe personat e lidhur me ta, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", nuk kanë të drejtë që, pas realizimit të shitjes të riblenjë pasurinë e shoqërisë apo të kërkojnë në gjykatë të drejtën për kthim në favor të tyre.

Neni 4

4.1 Radha e shitjes së pasurisë të shoqërisë caktohet nga administratori. Ky i fundit saktëson përpara fillimit të procesit të shitjes të drejtën e pronësisë, përkatësinë dhe vendos për formën e procedurën e shitjes, deri në arkëtimin e çmimit të shitjes së tyre.

4.2 Kalimi i pronësisë dhe të drejtave të tjera nga shitësi tek blerësi sjell pakësimin gradual të veprimtarisë së shoqërisë deri në shpërbërje dhe likuidimin e tyre.

4.3 Me shitjen e pasurisë së shoqërisë, konsulenti juridik, në emër të administratorit, bën veprimet e duhura për likuidimin dhe çregjistrimin e shoqërisë huamarrëse nga regjistri tregtar.

Konsulentët juridikë, për veprimet juridiko-civile që kryejnë, mbajnë përgjegjësi sipas dispozitave ligjore e penale në fuqi, kur ato bien ndesh me interesat pasurore të shoqërisë dhe të kreditorëve.

Neni 5

Subjektet e blerjes

Shitja e pasurive të shoqërisë është e lirë për të gjithë personat fizikë, a juridikë, vendas apo të huaj, me përjashtim të kufizimeve të caktuara në këtë ligj.

Neni 6

Format e shitjes

6.1 Shitja e pasurisë së shoqërisë realizohet në format e mëposhtme:

- a) Shitje direkte,
- b) Ankand,
- c) Tender publik.

6.2. Administratori, duke respektuar kriteret e vendosura në këtë ligj, përcakton formën e shitjes. Ai mundë të zbatojë një, disa ose të gjitha format e mësipërme. Në raste të veçanta mund të përdoret agjent për shitje.

6.3 Kreditori ka të drejtë të futet si blerës i parë në shitjen e pasurive të shoqërive huamarrëse, në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.8360, date 10.6.1998 "Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes se pasurisë të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", kur:

a) midis një apo më shumë blerësve pjesëmarrës në ankand janë ofruar çmime blerjeje të barabarta;

b) në ankandin apo tenderin e organizuar, ofertat e paraqitura janë më të vogla se çmimi fillestar i shitjes së caktuar nga grupi i vlerësimit të pasurisë së shoqërisë;

c) në kohën e hapjes së ankandit nuk është paraqitur asnjë ofertë nga ana e blerësve, por vetëm kërkesa e një apo grup kreditorësh, ku çmimi fillestar i shitjes së caktuar nga grupi i

vlerësimit arrihet të përputhet me shumën e detyrimit të mbetur, të llogaritur me koeficientin e kthimit të shumave kreditorëve.

6.4 Shitja direkte përdoret edhe për të gjithë ata persona fizikë a juridikë, vendas apo të huaj, të cilët sipas kontratës që do të lidhin me administratorët, blejnë kredinë që depozituesit kanë në shoqërinë huamarrëse.

Rregullat për procedurat, mënyrat e realizimit të shitjes ose të kalimit të kredive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Dokumentacioni i blerjes

7.1 Personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, të cilët kërkojnë të blejnë pasuritë e shoqërive huamarrëse, paraqesin pranë administratorëve dokumentet e mëposhtme:

- a) Kërkesa për objektin që ata do të blejnë.
- b) Dokumenti bankar që vërteton pagesën e 20 për qind të shumës që ai konkurren për blerje të objekteve që do të shiten.
- c) Deklarata me shkrim për konton bankar që disponon apo sasinë e mjeteve monetare cash.

7.2 Në çdo rast blerja e pasurive të shoqërive brenda vendit do të bëhet me lekë, ndërsa kur ato do të shiten jashtë Shqipërisë, edhe në valutë të huaj.

Neni 8

Përfshirjet

8.1 Personat fizikë e juridikë të lidhur me shoqëritë huamarrëse përfshihen nga e drejta e shitjes, blerjes ose çdo veprim tjetër juridiko-civil që sjell gëzimin e kësaj pronësie.

8.2 Nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë nëpërmjet blerjes së pasurisë të shoqërisë, vetë ose edhe nëpërmjet përfaqësuesit të tyre personat të cilët pas 1 janarit të vitit 1995 janë caktuar në detyra të larta si: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit Popullor, Kryetari i Këshillit të Ministrave, anëtarë të Këshillit të Ministrave dhe të barazuarit me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, deputetët e Kuvendit Popullor, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Kasacionit, zëvendësministrat, prefektët, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm, si dhe persona të tjerë të barazuar me ta, drejtorët e drejtorive të ministrave dhe të institucioneve të tjera qendrore, përgjegjësit e sektorëve në ministri dhe institucione të tjera qendrore, si dhe persona të tjerë të barazuar me ta, drejtues të organeve të pushtetit lokal si: kryetari i Këshillit të rrethit, kryetar bashkie e komune, si dhe specialistë në funksione të tjera drejtuese, si dhe çdo person tjetër që ka pengesë me ligj të veçantë.

8.3 Veprimet e kryera në kundërshtim me përmbajtjen e këtij neni, konsiderohen si veprime me mashtrim të ligjit dhe janë të pavlefshme. Në këto raste objektet përkatëse rrihen në shitje.

Neni 9

Vlerësimi

9.1 Pasuria e shoqërisë vlerësohet nga grupi i vlerësimit, i cili përcakton edhe çmimin fillestar të shitjes, çmimi publikohet vetëm kur hapet ankandi.

9.2 Përcaktimi i çmimit, publikimi dhe procesi i shitjes bëhet nga administratori.

Neni 10

Publikimi

10.1 Publikimi i shitjes bëhet jo më vonë se 20 ditë nga data e caktuar për shitje. Në rastet kur natyra e objektit është e tillë që kërkon një kohë më të gjatë, ky afat është nga një deri në tre muaj.

10.2 Publikimi bëhet së paku në dy gazeta me qarkullim kombëtar dhe në mjetet elektronike të informimit publik.

10.3 Njoftimi, sipas rastit, u dërgohet edhe përfaqësive tona jashtë shtetit, përfaqësive të huaja në veNë dhe agjencive investuese.

10.4 Në publikim përfshihen çështje të karakterit të përgjithshëm, ndërsa blerësve u ofrohen, kundrejt pagesës pranë qendrës së ankandit, katalogë të veçantë në formë broshure me të dhëna të hollësishme.

10.5 Në procesin e publikimit përdoret emërtimi i shoqërisë huarnarrëse dhe poshtë saj "shoqëri në administrim".

Neni 11

Koha e shitjes

11.1 Procesi i shitjes së pasurive të shoqërisë huamarrëse realizohet nga administratorët në afatin e përcaktuar në kontratën e lidhur dhe, si rregull, brenda vitit 1998.

11.2 Kur pasuritë e shoqërive nuk shiten në afatin e caktuar më sipër, shitja do të vazhdojë edhe pas vitit 1998. Në këto raste, Këshilli i Ministrave vendos për vazhdimin e procesit të administrimit, duke respektuar kriteret dhe rregullat e përcaktuara në këtë ligj,

Neni 12

Kontrata e shitjes

12.1 Kontrata e shitjes së pasurive të shoqërive huamarrëse hartohet nga administratorët, ku si palë janë shoqëritë huamarrëse, të përfaqësuara nga administratorët dhe blerësit.

12.2 Në kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve në procesin e shitjes.

12.3 Kalimi i pronësisë nga shitësi tek blerësi realizohet nga blerësi nëpërmjet konsulentëve juridikë të caktuar pranë administratorëve.

Neni 13

Komunikimi me publikun

13.1 Transparenca dhe legjitimiteti i procesit të shitjes së pasurive dhe i likuidimit të shoqërive shoqërohet nëpërmjet një komunikimi të vazhdueshëm me publikun si me buletinet mujore, konferencat e shtypit dhe në masmedia.

13.2 Administratorët në komunikimet me publikun shpallin tipet e objekteve që do të shiten për muajin pasardhës, format e shitjes dhe rezultatet e arritura në procesin e administrimit e të shitjes së pasurive.

Neni 14

Ankimi në gjykatë

Ekspertët kontabël të caktuar sipas legjislacionit në fuqi, kur gjatë procesit të shitjes dhe likuidimit të shoqërive huamarrëse konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, ngrejnë padi në gjykatë për pavlefshmërinë e shitjes dhe, brenda 30 ditëve nga koha e konstatimit, kërkojnë anulimin e tyre.

Neni 15
Dispozita kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatimi të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin e tij nga Presidenti i Republikës.

**Shpallur me dekretin nr.2184, datë 11.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**